



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref.nr.02/ 334 Dt.25/04/2016

Në mbështetje të nenit 23 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit "Kadri Zeka", si dhe në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës dhe të Udhëzimit Administrativ nr.01/2015 dt. 27.02.2015 të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve në Universitetin "Kadri Zeka" Gjilan, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me datën. 15.04.2016, miraton:

**Rregullat dhe Procedurat
për
Zgjedhjet e përgjithshme në UKZ**

1. Dispozitat e përgjithshme
 2. Rregullat zgjedhore
 3. Listat e votuesve
 4. Kandidatët
 5. Regjistrimi i kandidatëve
 6. Komisioni Qendror Zgjedhor
 7. Komisionet Zgjedhore të Fakulteteve
 8. Dita e zgjedhjeve
 9. Procedurat e votimit dhe fletëvotimet
 10. Rezultatet e zgjedhjeve – hedhja e shortit
 11. Periudha e ankesave
-

I. Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

1. Të gjitha rregullat dhe procedurat e mëtejme duhet t'i referohen dhe të bazohen në Statutin e UKZ dhe aktet tjera normative në fuqi.
2. Çdo ankesë kundër vendimeve të bazuara në këto rregulla dhe procedura duhet të adresohen:
 - së pari tek Komisioni Qendror Zgjedhor
 - së dyti tek Këshilli Drejtues i UKZ-së

Neni 2

1. Zgjedhjet si më poshtë do të mbahen në 4 fakultetet e UKZ.
 - 1.1 Anëtarët e këshillave të fakulteteve nga radhët e profesorëve.
 - 1.2 Anëtarët e këshillave të fakulteteve nga radhët e asistentëve.
 - 1.3 Anëtarët e këshillave të fakulteteve nga radhët e personelit jo-akademik.
 - 1.4 Anëtar i Senatit nga radhët e personelit akademik.
 - 1.5 Anëtari i Senatit nga radhët e personelit jo – akademik.

Neni 3

Personeli akademik i UKZ-së përfshin Profesorët, asistentet, ligjëruesit, lektorët.

Neni 4

1. Të gjithë ata kandidatë që i futen garës zgjedhore dhe të cilët zgjidhen ligjshëm përmes këtyre zgjedhjeve, do të mbajnë mandatin e tyre , siç përcaktohet me statut.
2. Në rast të dorëheqjes, ndërprerjes së kontratës, pensionimit, vdekjes, përjashtimit të mandatarit apo për shkak të ndonjë arsyeje tjetër, mandati do t'i takojë personit të parë në radhë sipas rezultateve fillestare të zgjedhjeve, të dala nga votat e fituara.
3. Në rastet kur nuk ka të zgjedhur nga rezultatet fillestare të zgjedhjeve, atëherë KD merr vendim për plotësimin e këtyre vendeve të lira (vakante).

Neni 5

1. Secili anëtar i personelit të UKZ-së në marrëdhënie të rregullt pune do të ketë të drejtë të marrë pjesë në këto zgjedhje.
2. Në rastet kontestuese në lidhje me të drejtën për të votuar ose të drejtën për kandidim, vendimi duhet të merret nga Komisioni Qendror Zgjedhor.
3. Për çdo vendim refuzues arsyet duhet të jepen në formë të shkruar nga ana e Komisionit Qendror Zgjedhor.

II.Rregullat zgjedhore

Neni 6

1. Anëtarët e këshillit të fakultetit nga radhët e profesorëve do të zgjidhen nga profesorët, ligjëruesit dhe lektorët e këtij fakulteti.
2. Anëtarë të këshillit të fakultetit do të zgjidhen me automatizëm deri në 10 profesorë, duke i përfshirë edhe ligjëruesit dhe lektorët dhe deri në 4 asistentë. Në këtë rast nuk do të mbahen zgjedhje.

Neni 7

1. Përzgjedhjen e anëtarëve të këshillit të fakultetit nga radhët e asistentëve do të votojë i tërë personeli akademik i fakultetit asistentë dhe profesorë.
2. Për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit të fakultetit nga radha e profesorëve votojnë vetëm profesorët.

Neni 8

1. Anëtarët e Senatit nga radhët e personelit akademik do të zgjedhën nga personeli akademik i secilit fakultet.
2. Përfaqësuesit e personelit akademik do të zgjedhën si anëtarë të Senatit nga secili fakultet.

Neni 9

1. Sekretari i Fakultetit (nëse ka) është anëtar *ex officio* i këshillit të fakultetit pa të drejtë vote.

2. Një anëtar i personelit jo – akademik do të zgjedhet si anëtar i këshillit të fakultetit.

Neni 10

1. Anëtari i Senatit nga radhët e personelit jo – akademik (administrativ) do të zgjedhet nga personeli jo akademik i UKZ – së.
2. Në rast të votave të barabarta të kandidatëve, përparësi do ti jepet gjinisë femërore. Nëse kandidatet me vota të barabarta janë të të njëjtës gjini, përzgjedhja do të bëhet përmes hedhjes së shortit.

III. Listat e votuesve

Neni 11

1. Administrata e fakulteteve dhe Administrata Qendrore e UKZ – së ka për detyrë t'i ofrojë të dhënat e kompletuara të votuesve me të drejtë vote Komisionit Qendror Zgjedhor.
2. Në rast të vonesës ose refuzimit për të dorëzuar të dhënat nga ndonjë fakultet, do të merren masa disiplinore nga ana e Këshillit Drejtues të UKZ – së pas njoftimit nga ana e Komisionit Qendror Zgjedhor.

Neni 12

1. Një listë e votuesve me të drejtë vote do të përgatitet nga Komisioni Qendror Zgjedhor për secilin njësi akademike, duke përfshirë të dhënat në vijim:

1.1 Personeli akademik:

1. Numri rendor
2. Emri
3. Mbiemri
4. Data e lindjes
5. Titulli profesional
6. Fusha kryesore e profesionit
7. Departamenti/Instituti

1.2 Personeli jo – akademik:

1. Numri rendor
2. Emri
3. Mbiemri
4. Data e lindjes
5. Titulli profesional
6. Fusha kryesore e profesionit
7. Departamenti/Instituti

IV. Kandidatët

Neni 13

1. Secili anëtar i personelit të UKZ-së që është regjistruar në listën e votuesve ka të drejtë të regjistrohet si kandidat për mandat siç ceket në nenin 2.
2. Të qenit anëtar në Komisionin Qendror Zgjedhor ose në ndonjë komision zgjedhor të fakultetit nuk është pengesë për të qenë kandidat në zgjedhjet e përgjithshme.
3. Votuesit me të drejtë vote kanë të drejtë të regjistrohen për më shumë se një mandat.
4. Nuk lejohet ushtrimi i më shumë se një mandati. Nëse një anëtar i personelit zgjidhet për më shumë se një mandat, duhet të deklarohet me shkrim se cilin mandat dëshiron t'a ushtroj. Nëse një anëtar i personelit shkel mbi këtë parim, Komisioni Qendror Zgjedhor i revokon të gjitha mandatet e këtij personi.
5. Procesi i zëvendësimit të mandateve pastaj bëhet sipas mënyrës së përshkruar në nenin 4 të kësaj Rregullore.

V. Regjistrimi i kandidatëve

Neni 14

1. Secili votues me të drejtë vote ka të drejtë të regjistrohet si kandidat për ndonjë mandat që i është caktuar kategorisë së tij/saj dhe fakultetit.
2. Duhet të përgatiten procedurat e regjistrimit për secilin fakultet.
3. Komisioni zgjedhor i fakultetit duhet të caktojë një periudhë për regjistrim prej orësh

08.00 dhe 14.00 gjatë ditës së regjistrimit, datë e cila do të shpallet nga Komisioni Qendror Zgjedhor.

4. Dita e regjistrimit duhet të jetë së paku 2 ditë para ditës së zgjedhjeve.
5. Votuesit me të drejtë vote të cilëve u pamundësohet pjesëmarrja në procedurat e regjistrimit duhet t'iu jepet mundësia të regjistrohen përmes aplikacioneve të shkruara.
6. Një formular përkatës për regjistrim, shtojca 1, do të jetë në dispozicion në administratën e UKZ-së dhe në ueb-faqen e UKZ-së.

Neni 15

1. Komisioni Qendror Zgjedhor është i obliguar të kontrollojë çdo regjistrim të kandidaturës për validitet, duke iu referuar listës së votuesve dhe dispozitave të këtyre rregullave dhe procedurave.
2. Lista zyrtare e kandidatëve do të përgatitet nga Komisioni Qendror Zgjedhor për secilin fakultet dhe administratën qendrore duke përfshirë të dhënat në vijim:

2.1 Personeli akademik:

1. Numri rendor
2. Emri
3. Mbiemri
4. Data e lindjes
5. Numri i Letërnjoftimit
6. Titulli profesional
7. Departamenti/Instituti

2.2 Personeli jo-akademik:

1. Numri rendor
2. Emri
3. Mbiemri
4. Data e lindjes
5. Numri i Letërnjoftimit
6. Fusha profesionale
7. Departamenti/Instituti

3. Lista zyrtare e kandidatëve do të publikohet nga Komisioni Qendror Zgjedhor në ditën e zgjedhjeve në dekanatet e fakulteteve dhe në ueb faqen e UKZ-së në internet.

VI. Komisioni Qendror Zgjedhor

Neni 16

1. Komisioni Qendror Zgjedhor do të përmbushë obligimet e veta, siç ceket në Statut dhe aktet tjera ligjore.
2. Komisioni qendror zgjedhore duhet te përbehet nga 3 anëtarë: Sekretari i përgjithshëm i UKZ si kryesues dhe dy anëtare të tjerë që i cakton KD

Neni 17

1. Secili anëtar i personelit do të ketë të drejtën të ankohet kundër vendimeve të Komisionit Qendror Zgjedhor në formë të shkruar dhe me arsyetim të bazuar tek Këshilli Drejtues i Universitetit. Vendimi rreth ankesës duhet të merret brenda 2 javëve pas pranimit. Vendimi i Këshillit Drejtues është vendimtar.

Neni 18

1. Protokollet e komisionit të zgjedhjeve duhet të përgatiten dhe nënshkruhen nga kryesuesi dhe anëtarët e KQZ.
2. Mbledhjet e KQZ thirren nga kryesuesi i KQZ

VII. Dita e zgjedhjeve

Neni 19

1. Komisioni Qendror Zgjedhor duhet të vendosë dhe të shpallë ditën e zgjedhjeve.
2. Në ditën e zgjedhjeve, vendvotimet duhet të bëhen në kohën dhe datën siç e përcakton KQZ.

Neni 20

1. Votuesit me të drejtë vote duhet që personalisht të hedhin votën në vendvotim të fakultetit, në të cilin janë caktuar sipas kontratës së tyre.
2. Asnjë votues nuk duhet të ketë të drejtë të votojë në më shumë se një vendvotim.

Neni 21

Komisioni Qendror Zgjedhor duhet të shpalle lokacionin e vendvotimeve.

Neni 22

Zgjedhjet mbahen, nën mbikëqyrjen e Komisionit Qendror Zgjedhor.

VIII. Procedurat e votimit dhe fletëvotimet

Neni 23

1. Gjatë kohës së votimit, së paku dy anëtarë të KQZ duhet të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës për të siguruar mbarëvajtje të rregullt të procedurave zgjedhore.
2. KQZ duhet të sigurojë hapat e mëtejme procedural për mbarëvajtje të zgjedhjeve:
 - 2.1 Hapja dhe mbyllja e vendvotimit në kohën e caktuar dhe mbajtja e vendvotimit; hapur gjatë periudhës së caktuar së zgjedhjeve;
 - 2.2 Ofrimi i materialeve të nevojshme për mbajtjen e votimeve;
 - 2.3 Shpërndarja e materialeve zgjedhore;
 - 2.4 Shënimi i procedurave të votimit në protokollin e komisionit zgjedhor;
 - 2.5 Vulosja e kutive të votimit dhe shënimi i numrave të vulave;
 - 2.6 Shënimi i sasisë dhe numërimi i votave;
 - 2.7 Shënimi i rezultateve të zgjedhjeve.

Neni 24

1. Procedura zgjedhore duhet të përmbajë hapat në vijim:

- 1.1 KQZ kërkon nga votuesi të identifikojë vetveten me dokument të identifikimit (letërnjoftim);
- 1.2 KQZ kërkon nga votuesi që të identifikohet me një nga kategoritë e personelit;
- 1.3 Komisioni i zgjedhjeve e gjen votuesin në listën e votuesve;
- 1.4 Komisioni zgjedhor kërkon nga votuesi të regjistrohet në listën e votuesve;
- 1.5 Komisioni zgjedhor i jep votuesit fletëvotimet e përshtatshme;
- 1.6 Votuesi fshehtazi shënon fletëvotimin në kabinën e votimit;
- 1.7 Komisioni zgjedhor zëvendëson një fletëvotim sipas kërkesës nëse votuesi e ka dëmtuar atë;
- 1.8 Votuesi e hedhë votën në kutinë e votimit;
- 1.9 Votuesi del nga vendvotimi menjëherë pas votimit;
- 1.10 Komisioni zgjedhor shënon në protokoll çdo ndryshim të këtyre procedurave.

Neni 25

1. Secili fletëvotim duhet të përmbajë emrat e të gjithë kandidatëve të cilët janë regjistruar për mandate të caktuara. Kandidatët duhet të radhiten në fletëvotim sipas mbiemrave dhe emrave.
2. Secili votues ka të drejtë të shënojë aq kandidatë sa edhe ka mandate në konkurrim në zgjedhjet e caktuara. Një lajmërim i përshtatshëm duhet të jepet në fillim të fletëvotimit.
3. Fletëvotimet janë valide kur maksimumi i kandidatëve të paracaktuar ose më pak – siç ceket në fletëvotim – janë shënuar dhe kur qëllimi i votuesit është i qartë.
4. Fletëvotimet janë jo valide kur shënohen më shumë kandidatë sesa maksimumi i paracaktuar – siç ceket në fletëvotim – ose kur nuk shënohet asnjë kandidatë.
5. Në të gjitha rastet e tjera të kontestimit të validitetit të fletëvotimit, vendimi duhet të merret nga Komisioni Qendror Zgjedhor sipas kërkesës së komisionit zgjedhor të fakultetit.

Neni 26

Secili votues me të drejtë vote ka të drejtë të dorëzojë ankesë në lidhje me procedurat e zgjedhjeve tek Komisioni Qendror Zgjedhor.

IX. Rezultatet e zgjedhjeve – hedhja e shortit

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është i obliguar të shpallë rezultatet zyrtare të zgjedhjeve brenda 24 orëve pas mbylljes së vendotimeve.
2. Në rastet kur dy ose më shumë kandidatë kanë marrë numrin e njëjtë të votave për një numër joadekuat të mandateve në dispozicion dhe kandidatet janë të të njëjtës gjini, atëherë duhet të organizohet hedhja e shortit nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që do të vendos për ndarjen përfundimtare të mandateve.
3. Nëse njëri nga kandidatet është femër, ka përparësi dhe zgjedhet pa short.

X. Periudha e ankesave

1. Pas shpalljes zyrtare të rezultateve, shpallet një periudhë 2 – ditore për ankesa.
2. Gjatë kësaj periudhe mund të dorëzohen ankesa me shkrim në lidhje me procedurat e zgjedhjeve, rezultatet e votimeve dhe të zgjedhurit.
3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka për detyrë të vendosë rreth të gjitha ankesave brenda periudhës së ankesave.
4. Pas përfundimit të kësaj periudhe, Komisioni Qendror Zgjedhor duhet të shpallë rezultatet zyrtare të zgjedhjeve.



Kryetari i Këshillit Drejtues

Akademik Fejzullah Krasniqi